



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KRYETARI I KOMUNËS**

Në bazë të nenit 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, në pajtim me Rregulloren MF - Nr - 04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenit 61 parag. 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, pas publikimit të rezultateve përfundimtare nga ana e Komisionit të përzgjedhjes së OJQ-ve për organizimin e aktiviteteve rinore/ kulturore, datë 20.04.2021, Kryetari i Komunës merr:

### **VENDIM**

#### **PËR MBËSHTETJE FINANCIARE ORGANIZATAVE JOQEVERITARE-OJQ NË KOMUNËN E PODUJEVËS**

##### **Neni 1**

Për financim publik të organizatave joqeveritare-OJQ, për realizimin e programeve/projekteve në fushën e aktiviteteve kulturore dhe rinore, sipas Thirrjes publike dt. 05.02.2021, ndahen mjete financiare në shumë të përgjithshme **6,100.00 €**.

##### **Neni 2**

Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit për kushtet dhe mënyrën e realizimit të aktiviteteve kulturore/rinore dhe për mënyrën e financimit publik, me secilin përfitues të mbështetjes financiare lidhë kontratë me shkrim në përputhje me Rregulloren mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe procedurën e përcaktuar në Udhëzimin për aplikuesit.

##### **Neni 3**

Lista përfundimtare e përfituesve me shumat përkatëse është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

##### **Neni 4**

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

##### **Neni 5**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Nr. 02-400/03-0036202/21**  
**Podujevë, 05 maj 2021**



**Kryetari i Komunës**  
**Shpejtim Bulliqi**



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KRYETARI I KOMUNËS**

Në bazë të nenit 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, në pajtim me Rregulloren MF - Nr - 04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenit 61 parag. 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, pas publikimit të rezultateve përfundimtare nga e Komisionit të përzgjedhjes së OJQ-ve për mbështetje financiare për projekt/programet që kontribuojnë në zbatimin e programit të DSHMS-së, i cili u dedikohet personave me nevoja të veçanta., datë 30.04.2021, Kryetari i Komunës merr:

### **VENDIM**

### **PËR MBËSHTETJE FINANCIARE ORGANIZATAVE JOQEVERITARE -OJQ NË KOMUNËN E PODUJEVËS**

#### **Neni 1**

Për financim publik të organizatave joqeveritare-OJQ për projekt/programet që kontribuojnë në zbatimin e programit të DSHMS-së, i cili u dedikohet personave me nevoja të veçanta, sipas Thirrjes publike dt. 01.03.2021, ndahen mjete financiare në shumë të përgjithshme **20,000.00 €**.

#### **Neni 2**

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për kushtet dhe mënyrën e realizimit të projekt/programeve sipas nenit 1 dhe për mënyrën e financimit publik, me secilin përfitues të mbështetjes financiare lidhë kontratë me shkrim në përputhje me Rregulloren mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe procedurën e përcaktuar në Udhëzimin për aplikuesit.

#### **Neni 3**

Lista përfundimtare e përfituesve me shumat përkatëse është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

#### **Neni 4**

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

#### **Neni 5**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Nr. 02-400/03-0036202/21**  
**Podujevë, 05 maj 2021**

**Kryetari i Komunës**  
**Shpejtim Bulliqi**



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11 dhe 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040, nenit 68 paragraf 7 të Ligjit për zyrtarët publik nr.06/L-114, Ligjit të punës nr.03/L-212, Udhëzimit Administrativ nr.07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, nxjerr,

### VENDIM PËR NGRITJEN E KOMISIONIT PËRZGJEDHËS

#### Neni 1

Për zhvillimin e procedurave dhe përzgjedhjen e kandidatëve për vendet e punës (2 vende të lira) - pozita; **Roje Pylli, në kuadër të Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – DBPZHR në Podujevë**, sipas konkursit me nr.prot.13-111/01-0028953/21 të shpallur përmes njoftimit/konkursit më 31 mars 2021, i ndërlidhur me afatin e aplikimit i cili fillon nga data 05 maj 2021, ngritet Komisioni, me këtë përbërje,

- |  |          |
|--|----------|
| 1. <b>Ymer Hoti</b> , zyrtar i pylltarisë 1 në DBPZHR-Podujevë,                | kryesues |
| 2. <b>Hamide Selmani</b> , zyrtare e pylltarisë 1 në DBPZHR,                   | anëtare  |
| 3. <b>Rrahmon Cakiqi</b> , inspektor i bujqësisë në Drejtorinë e Inspeksionit, | anëtar   |
| 4. <b>Tasim Hoti</b> , roje pylli në DBPZHR,                                   | anëtar   |
| 5. <b>Vahide Veseli</b> , zyrtare për zhvillim në DBPZHR,                      | anëtare  |

#### Neni 2

Komisioni, detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në përputhje me dispozitat e Ligjit të punës nr.03/L-212, Ligjit për zyrtarët publik nr.06/L-114, Udhëzimit Administrativ nr.07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, dhe akteve tjera përkatëse në fuqi.

#### Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*I'u dërgohet:*  
Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural  
Zyrës së Personelit  
Anëtarëve

Nr. prot. 02-020/04-0036177/21  
Podujevë,  
05 maj 2021





**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KRYETARI I KOMUNËS**

Në bazë të neneve 11 dhe 13 të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, neneve 14 dhe 16 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01/0050862/18, Vendimit nr.prot.01-400/01-0035819/21/21 të Kuvendit të Komunës së Podujevës, për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionimin e ndërtimit të shtëpive të banimit për familjet me gjendje të rëndë ekonomike të datës 29 prill 2021, si dhe në implementim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit për bashkëfinancimin e ndërtimit të shtëpive për familjet në nevojë e lidhur në mes Komunës së Podujevës dhe Shoqatës Bamirëse “Jetimat e Ballkanit” të datës 10 prill 2021, merr;

### **VENDIM**

#### **Neni 1**

Formohet komisioni për verifikimin dhe vlerësimin e aplikacioneve / kërkesave dhe përzgjedhjen e 10 familjeve me gjendje të rëndë ekonomike dhe të banimit në Komunën e Podujevës, përfutuese për ndërtimin e shtëpive të banimit të cilat do të ndërtohen në bashkëfinancim mes Komunës së Podujevës dhe Shoqatës Bamirëse “Jetimat e Ballkanit”, në këtë përbërje;

- |  |                  |
|--|------------------|
| - <b>Arbresha Bashota</b> , Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, | <i>kryesuese</i> |
| - <b>Ramadan Plakolli</b> , Drejtorja e Administratës,                       | <i>anëtar</i>    |
| - <b>Bled Latifi</b> , përfaqësues i Shoqatës “Jetimat e Ballkanit”,         | <i>anëtar</i>    |
| - <b>Rinor Hakaj</b> , përfaqësues i Shoqatës “Jetimat e Ballkanit”          | <i>anëtar</i>    |

#### **Neni 2**

Detyrat e komisionit janë, verifikimi i aplikacioneve / kërkesave të paraqitura për ndërtimin e shtëpive të banimit, vlerësimi i tyre si dhe përzgjedhja e 10 familjeve me gjendje të rëndë ekonomike dhe të banimit, përfutuese për ndërtimin e shtëpive të banimit, si dhe çështje tjera të parapara me Marrëveshjen e Bashkëpunimit për bashkëfinancimin e ndërtimit të shtëpive për familjet në nevojë e lidhur në mes Komunës së Podujevës dhe Shoqatës Bamirëse “Jetimat e Ballkanit”

#### **Neni 3**

Për punën e kryer komisioni përgatit raport në formë të shkruar dhe të njëjtin ia dorëzon Kryetarit të Komunës dhe një kopje Shoqatës Bamirëse “Jetimat e Ballkanit”.

#### **Neni 4**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*Iu dërgohet;*  
*Anëtarëve të Komisionit*  
*Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale*  
*Arkivës*

**Nr.prot.02-550/01-0036546/21**  
**Podujevë,**  
**06 maj 2021**



**Kryetari i Komunës**  
**Shpejtim Bulliqi**



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KRYETARI I KOMUNËS**

Në bazë të neneve 11 dhe 13 të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, neneve 14 dhe 16 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01/0050862/18, dhe në implementim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit për Projektin “Gratë Ndërmarrëse në Energji” e lidhur në mes Komunës së Podujevës dhe “Help Misioni në Kosovë” të datës 18 shkurt 2021, me nr.prot. 02-016/01-0013993/21, merr;

### **VENDIM**

#### **Neni 1**

**Memli Gashi**, zyrtar për regjistrimin e bizneseve në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik – DPZHE, Komuna e Podujevës, caktohet për monitorimin e implementimit të projektit “Gratë Ndërmarrëse në Energji” si pjesë e projektit “Subvencionet për Eficiencën e Energjisë në Kosovë të financuar nga fondacioni i Mijëvjeçarit në Kosovë dhe Ministria e punëve të jashtme Gjermane, projekt i cili zbatohet nga “Help Misioni në Kosovë”, sipas Marrëveshjes së Bashkëpunimit e lidhur në mes Komunës së Podujevës dhe “Help Misioni në Kosovë”

#### **Neni 2**

Detyrat e zyrtarit sipas nenit 1 të këtij vendimi, janë të përcaktuara në Marrëveshjen e Bashkëpunimit e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

#### **Neni 3**

Pas përfundimit të projektit sipas Marrëveshjes së cekur, zyrtari i caktuar përgatit raport në formë të shkruar dhe të njëjtin ia dorëzon Kryetarit të Komunës, përmes Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik.

#### **Neni 4**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*Iu dërgohet;*  
*Të caktuarit*  
*Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik*  
*Help Mision në Kosovë – për njoftim*  
*Arkivës*

**Nr.prot.02-020/05-0037892/21**  
**Podujevë,**  
**12 maj 2021**





**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KRYETARI I KOMUNËS**

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L – 040, nenin 2 parag. 5 dhe 6 të Rregullores së MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, sipas kërkesës nr.prot.09-615/03-0032539/21 të datës 14.04.2021 të OJQ - Klubi i Peshkatarëve Sportiv Rekreativ i personave me aftësi të kufizuara “Llapi” Podujevë, të proceduar nga Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, Kryetari i Komunës merr:

**VENDIM**  
**PËR MBËSHTETJE FINANCIARE**  
**OJQ - KLUBI I PESHKATARËVE SPORTIV REKREATIV I PERSONAVE ME**  
**AFTËSI TË KUFIZUARA “LLAPI” PODUJEVË**

**Neni 1**

OJQ - Klubi i Peshkatarëve Sportiv Rekreativ i personave me aftësi të kufizuara “Llapi” Podujevë, për organizimin e turneut në garat e peshkatarisë sportive për personat me aftësi të kufizuara, i cili do të mbahet në Liqenin e “Batllavës”, në fshatin Orllan, mbështetet me mjete financiare në shumë 500.00 €.

**Neni 2**

Obligohet Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit që për realizimin e këtij projekti, të lidhë kontratë me përfituesin duke respektuar standardet themelore të financimit lidhur me kontraktimin, monitorimin, publikimin dhe raportimin sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje.

**Neni 3**

Mjetet buxhetore ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe përmes bankës barten në llogarinë e OJQ - Klubi i Peshkatarëve Sportiv Rekreativ të personave me aftësi të kufizuara “Llapi” Podujevë.


**Neni 4**

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Buxhetit dhe Financave dhe Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit.

**Neni 5**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Nr.02-400/04-0037308/21**  
**Podujevë, 07 maj 2021**



**Kryetari i Komunës**  
**Shpejtim Bulliqi**



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KRYETARI I KOMUNËS**

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 2 parag. 5 dhe 6 të Rregullores së MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, sipas kërkesës nr.09-400/04-0004970/21 të datës 20.01.2021 të OJQ Klubi i Shahut “Hyzri Talla”-Podujevë të proceduar nga Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, Kryetari i Komunës merr:

### **VENDIM PËR MBËSHTETJE FINANCIARE OJQ - KLUBI I SHAHUT “HYZRI TALLA”-PODUJEVË**

#### **Neni 1**

OJQ-Klubi i Shahut “Hyzri Talla”-Podujevë, për realizimin dhe pjesëmarrjen në aktivitete garuese të shahut në turne kombëtare dhe ndërkombëtare, mbështetet me mjete financiare, në shumë 500.00 €.

#### **Neni 2**

Obligohet Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit që për realizimin e këtij projekti, të lidhë kontratë me përfituesin duke respektuar standardet themelore të financimit lidhur me kontraktimin, monitorimin, publikimin dhe raportimin sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje.

#### **Neni 3**

Mjetet buxhetore ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe përmes bankës barten në llogarinë e OJQ - Klubi i Shahut “Hyzri Talla”-Podujevë

#### **Neni 4**

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Buxhetit dhe Financave dhe Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit.

#### **Neni 5**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Nr.02-020/04-0038298/21**  
**Podujevë, 14 maj 2021**



**Kryetari i Komunës**  
**Shpejtim Bulliqi**



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KRYETARI I KOMUNËS**

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 2 parag. 5 dhe 6 të Rregullores së MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, sipas kërkesës nr.12-320/01-0038541/21 të datës 14.05.2021 të OJQ – Shoqata e Bletarëve “Llapi” – Podujevë, të proceduar nga Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me kërkesën nr.prot.02-320/04-0039021/21 të datës 17.05.2021, Kryetari i Komunës merr:

### **VENDIM PËR MBËSHTETJE FINANCIARE OJQ-në SHOQATA E BLETARËVE “LLAPI” NË PODUJEVË**

#### **Neni 1**

OJQ Shoqata e Bletarëve “Llapi” në Podujevë, për mbulimin e shpenzimeve për manifestimin e *Ditës Botërore të Bletës*, që do të mbahet më 20 maj 2021, mbështetet me mjete financiare, në shumë 300.00 €.

#### **Neni 2**

Obligohet Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural që për realizimin e këtij projekti, të lidhë kontratë me përfituesin duke respektuar standardet themelore të financimit lidhur me kontraktimin, monitorimin, publikimin dhe raportimin sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje.

#### **Neni 3**

Mjetet buxhetore ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, dhe përmes bankës barten në llogarinë e OJQ Shoqata e Bletarëve “Llapi” – Podujevë

#### **Neni 4**

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Buxhetit dhe Financave dhe Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

#### **Neni 5**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Nr.02-320/04-0039073/21**  
**Podujevë, 17 maj 2021**



**Kryetari i Komunës**  
**Shpejtim Bulliqi**





**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KRYETARI I KOMUNËS**

Bazuar në nenin 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-0050862/18, në pajtim me nenin 12 të Rregullores MF - Nr – 04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, Kryetari i Komunës, merr:

### **V E N D I M**

#### **PËR SHPALLJEN E THIRRJES PUBLIKE PËR MBËSHTETJE FINANCIARE PUBLIKE PËR PROJEKTE/PROGRAME TË ORGANIZATAVE JO- QEVERITARE NË KOMUNËN E PODUJEVËS**

##### **Neni 1**

1. Për implementimin e thirrjes publike do të zbatohen dispozitat e Rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

2. Mbështetja financiare publike për projektet/programet e OJQ-ve në Komunën e Podujevës bëhet në fushën e aktiviteteve kulturore **“Art në Hapësira Publike”**, nga buxheti i Komunës së Podujevës, kodi ekonomik 21200, në kuadër të programit/nënprogramit 85005.

##### **Neni 2**

Mjetet e financiare shpërndahen në bazë thirrjes publike për financimin e projekteve të OJQ-ve, pas vlerësimit dhe përzgjedhjes nga ana e komisionit si dhe dokumentacionit për zbatimin e thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

##### **Neni 3**

1. Dokumentacioni për zbatimin e thirrjes sipas pikës II të këtij vendimi përshinë:

- 1.1. Teksti i thirrjes publike
- 1.2. Udhëzimet për aplikantët
- 1.3. Formularët e aplikimit sipas Rregullores MF-Nr.04/2017.

#### **Neni 4**

Thirrja publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes do të publikohen në mënyrë të plotë në faqen e internetit të Komunës së Podujevës <https://kk.rks-gov.net/podujeve/>.

#### **Neni 5**

1.Në përputhje me Rregulloren për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ-të dhe udhëzuesit për aplikantët, do të formohet Komisioni Vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara të thirrjes publike.

2.Komisioni vlerësues do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve të projekteve të pranuar që kanë përmbushur me sukses kushtet formale për të qenë pjesë e konkurrimit sipas paragrafit 1 të këtij neni.

3.Komisioni Vlerësues punët dhe detyrat do t'i ushtrojnë në përputhje me rregullat parapara me Rregulloren për financimin publik të OJQ-ve dhe procedurën e përcaktuar në Udhëzimin për aplikuesit.

#### **Neni 6**

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit.

#### **Neni 7**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Nr. 02-615/02-0039189/21**  
**Podujevë, 18 maj 2021**





**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## **KRYETARI I KOMUNËS**

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenet 9.1 dhe 13.2), 3) të Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nr.01/111-400 dhe Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr. 01/172-400, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr. 02-020/04-0002354 të datës 12 janar 2021, për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere merr:

### **VENDIM PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PERSONAVE NË GJENDJE TË RËNDË SOCIALE E SHËNDETËSORE**

#### **Neni 1**

Shtatëdhjetë e katër (74) personave në gjendje të rëndë sociale-ekonomike dhe shëndetësore u jepet ndihmë financiare, në shumë të përgjithshme 7,550.00€, sipas shumave individuale të paraqitura në listën e rekomanduar nga komisioni përkatës.

#### **Neni 2**

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Shuma e mjeteve individuale nuk tejkalon shumën e mjeteve financiare sipas Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere.

#### **Neni 3**

Lista e përfituesve të ndihmës financiare është pjesë përbërëse e Vendimit.

#### **Neni 4**

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

#### **Neni 5**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Nr.02-400/03-0039740//21**  
**Podujevë, 19 maj 2021**



**Kryetari i Komunës**  
**Shpejtim Bulliqi**



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KRYETARI I KOMUNES**

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L – 040, nenin 10 parag.1 shkronja c) të Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transferë, nr.01/111-400 dhe Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transferë nr.01/172-400, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr. 02-020/04-0002354/21, për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transferë, Kryetari i Komunës, merr:

### **VENDIM**

#### **PËR MBËSHTETJE FINANCIARE SPORTISTIN REXHEP ZHEGROVA-BODIBUILDER NË KOMUNËN E PODUJEVËS**

##### **Neni 1**

z.Rexhep Zhegrova, nga Komuna e Podujevës, për marrjen pjesë në Kampionatin Botëror për Bodibuilding i cili do të mbahet në nëntor 2021 në Boidorn të Spanjës, mbështetet me mjete financiare, në shumë 1000 €.

##### **Neni 2**

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transferëve në kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe përmes bankës barten në llogarinë e z.Rexhep Zhegrova.

##### **Neni 3**

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

##### **Neni 4**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Nr. 02-400/03-0040432/21**  
**Podujevë, 20 maj 2021**





**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KRYETARI I KOMUNËS**

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L – 040, nenin 2 parag. 5 dhe 6 të Rregullores së MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, sipas kërkesës nr.09-615/03-0037468/21 të datës 11.05.2021 të OJQ-Shoqëria Bjeshkatore Alpiniste “Llapi”, të proceduar nga Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, merr:

### **VENDIM PËR MBËSHTETJE FINANCIARE OJQ -SHOQËRIA BJESHKATARE ALPINISTE “LLAPI”**

#### **Neni 1**

OJQ-Shoqëria Bjeshkatore Alpiniste “Llapi”, për realizimin e ecjes-marshutës në shtegun Popovë-Llapashticë-Bradash-Kaçandoll që i dedikohet të ndjerit Agim Kikaj, mbështetet me mjete financiare, në shumë 400.00 €.

#### **Neni 2**

Obligohet Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit që për realizimin e këtij projekti, të lidhë kontratë me përfituesin duke respektuar standardet themelore të financimit lidhur me kontraktimin, monitorimin, publikimin dhe raportimin sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje.

#### **Neni 3**

Mjetet buxhetore ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe përmes bankës barten në llogarinë e OJQ-Shoqëria Bjeshkatore Alpiniste “Llapi”.


#### **Neni 4**

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

#### **Neni 5**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Nr.02-400/03- 0040649 /21**  
**Podujevë, 21 maj 2021**



**Kryetari i Komunës**  
**Shpejtim Bulliqi**



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republik of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KRYETARI I KOMUNËS**

Mbështetur në neni 58 shkronjat b) dhe g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040 dhe neni 61 paragrafët 1.2 dhe 1.7 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18, jep :

### **A U T O R I Z I M**

#### **I**

**Autorizohet z.Musli Kutleshi**, zyrtar i lartë për ndërtimtari, të kryej edhe punët dhe detyrat si dhe të nënshkruaj dokumentacionin nga kompetencat dhe përgjegjësitë e udhëheqësit të Sektorëve në kuadër të Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit .

#### **II**

Autorizimi vlen deri në një akt tjetër administrativ.

#### **III**

I përmenduri sipas këtij autorizimi përfiton pagën me komponentët e tij më të lartë ndërmjet pagës së pozitës të mëparshme dhe asaj në të cilën autorizohet.


#### **IV**

I përmenduri deponon nënshkrimin për vulosjen e dokumentacionit nga fushë veprimtaria e pozitës së udhëheqësit të Sektorëve në kuadër të Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit .

Nënshkrimi i të autorizuarit \_\_\_\_\_

*U dërgohet:*  
*Drejtorisë së DPUMM*  
*Zyrës së Personelit*  
*Të autorizuarit*  
*Arkivit*

**Nr. prot. 02-020/05-0040983/21**  
**Podujevë, 24 maj 2021**





**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KRYETARI I KOMUNËS**

Bazuar në nenin 58 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenin 14.2 të Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nr.01/111-400 dhe Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr. 01/172-400 dhe Vendimin për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2021 dhe parashikimet buxhetore 2022-2023 nr.01-400/03-0059131/20, dt. 30.09.2020, sipas konkursit të Drejtorisë së Arsimit nr. 05-68 dt.09.02.2021, në rekomandim të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.02-020/04-0002354/21, dt. 12 janar 2021 për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere, Kryetari i Komunës, merr:

### **V E N D I M**

#### **Neni 1**

1. Pas shqyrtimit të ankesave dhe rishqyrtimit të aplikacioneve dhe në rekomandim të Komisionit, tërhiqen Listat e publikuara të nxënësve dhe studentëve, përfitues të bursës dhe aprovohen Listat e korigjuara për ndarjen e bursave për vitin akademik / mësimor 2020-2021, dhe atë:

1.1. Shtatëdhjetë (70) studentëve të Komunës së Podujevës, të cilët vijnë studimet në fakultet e Universiteteve Publike të Republikës së Kosovës, u ndahet bursë në shumë prej 400 € (shuma e përgjithshme 28,000 €), për vitin akademik 2020-2021.

1.2. Njëqind e njëzet e katër (124) nxënësve të Shkollave të Mesme të Komunës së Podujevës, u ndahet bursë, në shumë prej 200 € (shuma e përgjithshme 24,800 €), për vitin mësimor 2020-2021.

#### **Neni 2**

Shuma e mjeteve individuale nuk tejkalon shumën e mjeteve financiare sipas Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere.

#### **Neni 3**

Pagesa e mjeteve sipas nenit 1 të këtij Vendimi bëhet nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Arsimit.

#### **Neni 4**

Pjesë përbërëse e Vendimit janë Listat e përfituesve të bursave.

#### **Neni 5**

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Arsimit.

Nr.02-670/02-0042682/21  
Podujevë, 28 maj 2021



**Kryetari i Komunës**  
**Shejtim Bulliqi**



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KRYETARI I KOMUNES**

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L – 040, nenin 10 parag.1 shkronja c) të Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nr.01/111-400 dhe Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr.01/172-400, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr. 02-020/04-0002354/21, për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere, Kryetari i Komunës, merr:

### **VENDIM**

#### **PËR MBËSHTETJE FINANCIARE VALDET RAMA PËR ORGANIZIMIN E MANIFESTIMIT PËR NDER TË DITËS SË FËMIJËVE “1 QESHORI”**

##### **Neni 1**

z.Valdet Rama, me vendbanim në Prishtinë, për organizimin e shfaqjes për nder të ditës së fëmijëve “1 Qeshorit”, i cili do të mbahet më datë 1 Qeshor 2021 në teatrin “Avdush Hasani” në Podujevë, mbështetet me mjete financiare, në shumë 250.00 €.

##### **Neni 2**

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe përmes bankës barten në llogarinë e z.Valdet Rama.

##### **Neni 3**

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

##### **Neni 4**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Nr. 02-400/03-0042932 /21**  
**Podujevë, 28 maj 2021**



**Kryetari i Komunës**  
**Shpejtim Bulliqi**





**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KRYETARI I KOMUNËS**

Në bazë të nenit 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, në pajtim me Rregulloren MF - Nr - 04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenit 61 parag. 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, pas publikimit të rezultateve përfundimtare (datë 06.05.2021) nga ana e Komisionit vlerësues të përzgjedhjes së OJQ-ve, me nr. prot. 02-020/04-0032930/21, datë 16 prill 2021, Kryetari i Komunës merr:

### **V E N D I M**

#### **PËR MBËSHTETJE FINANCIARE TË ORGANIZATAVE JOQEVERITARE-OJQ NË KOMUNËN E PODUJEVËS**

##### **Neni 1**

Për financim publik të organizatave joqeveritare-OJQ në Komunën e Podujevës, për realizimin e programeve/projekteve në fushën e aktiviteteve kulturore për shfaqje teatrore për skenën e mbrëmjes dhe shfaqje për fëmijë për repertorin e Teatrit të Qytetit të Podujevës "Avdush Hasani", sipas Thirrjes publike dt. 01.03.2021, përsëritur më 19.03.2021, ndahen mjete financiare në shumë të përgjithshme **31,000.00 €**.

##### **Neni 2**

Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit për kushtet dhe mënyrën e realizimit të programeve/projekteve dhe për mënyrën e financimit publik, me secilin përfitues të mbështetjes financiare lidhë kontratë me shkrim në përputhje me Rregulloren mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe procedurën e përcaktuar në Udhëzimin për aplikuesit.

##### **Neni 3**

Lista përfundimtare e përfituesve me shumat përkatëse është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

##### **Neni 4**

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

##### **Neni 5**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Nr. 02-400/03-0043135/21**  
**Podujevë, 31 maj 2021**



**Kryetari i Komunës**  
**Shpejtim Bulliqi**